



UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”, KORÇË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

VITI AKADEMIK 2023-2024

(Përmbledhje e rekomandimeve nga raportet e katër fakulteteve)

NJSBC :

- 1. Dr. Aldona Minga**
- 2. Dr. Juliana Çyfeku**
- 3. Dr. Landi Gushi**
- 4. Doc. Ardian Matka**
- 5. Dr. Evis Kapurani**
- 6. Msc. Xhovan Saraçi**
- 7. Edona Kolludra (Studente)**

PARIMET E PUNËS SË NJSBC

- Vlerësimi i Cilësisë duhet të karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.
- Zhvillimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) në Njësitë e IAL realizojnë vlerësimin e brendshëm me synimin që të krijohet një pamje e qartë dhe transparente e njësisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të IAL-së dhe të programeve të studimit.
- Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.
- Të shërbejë për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në IAL si pjesë e brendshme dhe e qëndrueshme.
- Vlerësimi të bëhet i mbështetur në dokumente, procedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.

HYRJE

Ky raport prezanton rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve profesionale, referuar Nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikime, programeve të ciklit të parë të studimit “Bachelor” dhe programeve të ciklit të dytë “Master” në Universitetin “Fan S. Noli” në Korçë, kryer nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm.

Qëllimi i këtij procesi është që të sigurojë një vlerësim korrekt, të bazuar në tregues realë dhe të matshëm të nivelit të arritjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit të përfshirë në vlerësim, të përgatisë një raport i cili do të shërbejë si bazë për grupin e vlerësimit të jashtëm, gjatë procesit të akreditimit.

Për të përmbushur me sukses këtë qëllim, NJSBC është bërë pjesë e trajnimeve paraprake të organizuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Universitetit, mbi bazën e përvojës së vlerësimeve të mëparshme, duke hartuar edhe një plan pune, duke ndarë detyrat dhe duke udhëzuar NJSBC për përmbushjen e detyrave.

Për hartimin e këtij raporti, NJSBC ka mbajtur parasysh raportin e viteve të kaluara, si dhe raportin e GVJ që është realizuar në kuadër të akreditimit institucional.

Gjithashtu u shfytëzuan të gjitha materialet, të dhënat e Fakultetit, vlerësimet e kryera nga studentët për procesin mësimor, për stafin akademik, për infrastrukturën. Dokumentacioni bazë, mbi të cilin u mbështet procesi i Vlerësimit të Brendshëm:

- Ligj nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë
- Standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve
- Udhëzimet e MASR-së
- Dokumente të veprimtarisë institucionale të Universitetit “Fan S. Noli”, më konkretisht:
 - Statuti i UK-së,

- Rregullore e UK-së,
- Rregulloret e fakulteteve
- Rregulloret e Programeve të studimit
- Rregullore e transferimeve
- Planet mësimore - Formularët e ngarkesës vjetore të stafit

PËRSHKRIMI I UNIKO

Aktualisht UNIKO përbëhet nga katër fakultete, përkatësisht Fakulteti i Bujqësisë, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë dhe Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane. Fakultetet janë të organizuara në 15 departamente.

Në universitet funksionon “Qendra për Formimin e Vazhduar”, si njësi bazë kërkimore, trajnuese dhe strukturë e formimit të vazhduar, misioni i të cilës është trajnimi i mësuesve në detyrë. Njësi e Fakultetit të Bujqësisë është edhe Ekonomia Didaktike Eksperimentale (më tej, EDE) e cila ofron infrastrukturë për kërkim shkencor dhe praktikën profesionale të programeve të studimit të këtij fakulteti.

Studimet në UNIKO janë organizuar në cikle, duke përmbushur kështu kriteret e parashtruara në Deklaratën e Bolonjës. Ai ofron 7 programe studimi të karakterit profesional 2-vjeçar (120 kredite), 26 programe të ciklit të parë (180 kredite), 14 programe të ciklit të dytë master profesional (60 kredite), 1 program i ciklit të dytë master profesional (120 kredite), 11 programe Master i Shkencave (120 kredite) dhe 1 program të ciklit të tretë / PhD.

Personeli akademik e promovon vazhdimisht kërkimin e tij shkencor në aktivitete shkencore rajonale, kombëtare, mbarëkombëtare dhe ndërkombëtare.

Ai ka formuar tashmë një bibliografi të pasur botimesh në revista të rëndësishme shkencore. “Buletini Shkencor”, një botim i indeksuar i UNIKO që prej vitit 1996, e ka përmirësuar vazhdimisht cilësinë e hulumtimit dhe publikimit të rezultateve me vlera të qëndrueshme shkencore. Buletini botohet në dy seri: në Serinë e Shkencave të Aplikuara dhe Serinë e Shkencave Sociale.

UNIKO është partner në disa projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, fokusi kryesor i të cilave ka qenë jo vetëm shkëmbimi i përvojave akademike nëpërmjet mobilitetit të stafit dhe studentëve, por edhe përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit, i formave të mësimdhënies dhe të nxënies si dhe infrastrukturës në dispozicion të tyre.

Në vitin akademik 2022-2023 UNIKO aplikoi dhe përfundoi me sukses procesin e Akreditimit Periodik Institucional nga Agjencia Britanike e Akreditimit. Bazuar në VBA nr. 02, datë 27.01.2023 “Për akreditimin institucional të Universitetit “Fan S. Noli”” periudha e vlefshmërisë së akreditimit institucional është 26.01.2027.

UNIKO është vazhdimisht në kërkim të mjeteve dhe mënyrave për të promovuar kontekstin e duhur të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor për edukimin qytetarëve të ardhshëm dhe profesionistëve të kualifikuar që do të mundësojnë integrimin e vendit tonë në një kontekst më të gjerë vlerash evropiane.

Misioni dhe objektivat

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë në gjithë veprimtarinë e tij ka për mision kryesor të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor,

- të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend;
- të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal;
- të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor, si dhe të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë.

Nëpërmjet këtij raporti NJSBC do të evidentojë përmbushjen e standardeve të cilësisë për të gjitha fushat e vprimtarisë së UNIKO. Informacioni dhe të dhënat që do të nxirren nëpërmjet këtij raporti do të shërbejnë si indikatorë për përmirësimin e veprimtarisë së njësive kryesore dhe atyre bazë në UNIKO, si dhe do të vendosen në dispozicion të proceseve të vlerësimit të jashtëm institucional ose të programeve të studimit.

Synimet e programeve të studimit

Të gjitha programet e studimit janë hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit. Objektivat e tyre përfshijnë kualifikimet e parashikuara në planin strategjik dhe oferta e tyre akademike përputhet me kompetencën që synohet të përftohet në përfundim të tyre, duke përfshirë përgatitjen e specialistëve të aftë për tregun e punës.

Rregulloret e programeve të studimit japin informacion në lidhje me rezultatet e të nxënit, mundësitë për punësim apo mundësitë për të ndjekur studime të mëtejshme në cikle më të larta. Programet mësimore pasqyrojnë njohuritë e përvetësuara dhe rezultatet e të nxënit të lëndëve, të cilat janë hartuar për të plotësuar kornizën e kompetencave të programit të studimit si dhe titullin e diplomës.

Të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë i përfshijnë studentët në praktikë profesionale. Disa programe “Bachelor” ofrojnë, gjithashtu, periudha më të shkurtra praktike, në mënyrë që të përforcojnë fitimin e kompetencave profesionale nga ana e studentëve. Kurrikulat e programeve të studimit janë hartuar me bazë kompetencat edhe sipas përcaktimeve të akteve nënligjore.

Tabela e programeve të studimit që ofron UNIKO.

	PROGRAMI I STUDIMIT	KREDITET	FAKULTETI
1	Program profesional 2- vjeçar "Shërbim Social"	120	FSHNSHH
2	"Bachelor" në "Shkenca Politike"	180	FSHNSHH
3	"Bachelor" në "Administrim dhe Politika Sociale"	180	FSHNSHH
4	"Bachelor" në "Teknologji Informacioni"	180	FSHNSHH
5	"Bachelor" në "Inxhinieri Informatike" (Program i përbashkët me Universitetin Politeknik të Tiranës)	180	FSHNSHH
6	"Bachelor" në "Matematikë-Informatikë"	180	FSHNSHH
7	"Bachelor" në "Matematikë-Fizikë"	180	FSHNSHH
8	"Bachelor" në "Infermier i përgjithshëm"	180	FSHNSHH
9	"Bachelor" në "Mami"	180	FSHNSHH
10	"Bachelor" në "Biologji- Kimi"	180	FSHNSHH
11	"Master Profesional" në "Administrim Publik"	60	FSHNSHH

12	"Master Profesional" në "Sistemet Moderne të Telekomunikacionit dhe Teknologjitë e Internetit"	60	FSHNSHH
13	"Master Profesional" në "Infermieristikë"	60	FSHNSHH
14	"Master i Shkencave" në "Etika dhe Liderhipi"	120	FSHNSHH
15	"Master i Shkencave" në "Mësuesi në Shkencat Sociale"	120	FSHNSHH
16	"Master i Shkencave" në "Mësuesi në Matematikë-Fizikë"	120	FSHNSHH
17	"Master i Shkencave" në "Statistikë e Aplikuar"	120	FSHNSHH
18	"Master i Shkencave" në "Mësuesi në Biologji-Kimi"	120	FSHNSHH
19	Program profesional 2- vjeçar "Asistent Menaxher"	120	FEKO
20	"Bachelor" në "Informatikë Biznesi"	180	FEKO
21	"Bachelor" në "Ekonomiks"	180	FEKO
22	"Bachelor" në "Financë - Kontabilitet"	180	FEKO
23	"Bachelor" në "Menaxhim"	180	FEKO
24	"Bachelor" në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje"	180	FEKO
25	"Bachelor" në "Administrim Biznesi në Marketing"	180	FEKO
26	"Master profesional" në "Bankë dhe Sigurime"	60	FEKO
27	"Master profesional" në "Guidë Turistike"	60	FEKO
28	"Master profesional" në "Administrim Biznesi"	60	FEKO
29	"Master profesional" në "Financë - Kontabilitet"	60	FEKO
30	"Master profesional" në "Marketing"	60	FEKO
31	"Master profesional" në "Menaxhim i Turizmit Atraksioneve dhe Eventeve"	60	FEKO
32	"Master profesional" në "Marketingu Digjital"	60	FEKO
33	"Master i Shkencave" në "Financë"	120	FEKO
34	Program profesional 2- vjeçar "Mbështetës Zyre për Komunikimin, Bibliotekë dhe Arkivë"	120	FEF
35	Program profesional 2- vjeçar "Edukim për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme"	120	FEF
36	"Bachelor" në "Histori-Gjeografi"	180	FEF
37	"Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor"	180	FEF
38	"Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"	180	FEF
39	"Bachelor" në "Gjuhë Angleze"	180	FEF
40	"Bachelor" në "Gjuhë dhe Kulturë Frënge"	180	FEF
41	"Bachelor" në "Gjuhë- Letërsi"	180	FEF
42	"Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte"	180	FEF
43	"Bachelor" në "Gjuhë- Letërsi shqipe dhe gjuhë pakicash"	180	FEF
44	"Master Profesional" në "Mësues për Arsimin Fillor"	120	FEF
45	"Master i Shkencave" në "Mësuesi në Histori-Gjeografi"	120	FEF
46	"Master i Shkencave" në "Mësuesi në Gjuhën Angleze"	120	FEF
47	"Master i Shkencave" në "Mësuesi në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi"	120	FEF
48	"Master i Shkencave" në "Mësuesi në Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet"	120	FEF
49	"Master i Shkencave" në "Kulturë, Media dhe Editim"	120	FEF
50	Program profesional 2- vjeçar "Menaxhim Biznesi Bujqësor"	120	FB
51	Program profesional 2- vjeçar "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve"	120	FB
52	Program profesional 2- vjeçar "Menaxhim Veterinar"	120	FB
53	Bachelor në "Teknologji Ushqimore"	180	FB
54	Bachelor në "Menaxhim Agrobiznesi"	180	FB
55	Bachelor në "Inxhinieri Agronomike"	180	FB
56	Master Profesional në "Inxhinieri Agrare, Profili Hortikulturë"	60	FB
57	Master Profesional në "Cilësia dhe Siguria Ushqimore"	60	FB

58	"Master Profesional" në "Drejtimit Agrobiznesi"	60	FB
59	"Master Profesional" në "Menaxhimin e Qëndrueshëm në Agroturizëm" (Program i përbashkët me universitetin e Plovdiv-it Bullgari)	60	FB
60	"Doktoratë" në "Hortikulturë e Qëndrueshme"		FB
61	"Program i Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike"	35	FEF

Objektivat e përgjithshme

Rregulloret e programeve të studimeve janë të pajisura me informacion të përditësuar në lidhje me kurrikulën, planin mësimor, kategorizimin e disiplinës, kreditet përkatëse dhe ngarkesën mësimdhënëse/ të të nxëniet, mundësitë e punësimit, kriteret e pranimit, procedurat e diplomimit, rregullat e pjesëmarrjes dhe format e vlerësimit, infrastruktura në dispozicion dhe programe të detajuara lëndore. Objektivat klasifikohen si "të përgjithshme", në referencë të formimit të përgjithshëm të programit të studimit dhe "specifike", duke paraqitur rezultatet e të nxëniet dhe kompetencat që fitohen.

Të gjitha këto u bëhen të ditura studentëve nëpërmjet përshkrimit të shkurtër të objektivave dhe menaxhimit të përgjithshëm të programit të studimit, gjatë javës së parë të studimeve të tyre. Pjesë të përmbajtjes së programit paraqiten edhe në stendat e holleve të fakulteteve. Plani mësimor dhe elementet përkatëse, sipas kurseve, pasqyrohen edhe në faqen e internetit. Në fillim të lëndës/modulit, pedagogu bën të ditura objektivat e saj, format e studimit, rezultatet e të nxëniet, zërat e vlerësimit të vazhduar, mënyrën e zhvillimit të provimit dhe vlerësimit të tij, detyrimet e studentëve për frekuentimin dhe çdo element tjetër që lidhet me zhvillimin e lëndës.

Sistemi digjital i ruajtjes së të dhënave siguron informacion të plotë në lidhje me kurrikulat dhe elementet e tyre përbërëse. Në llogarinë personale, studenti gjen detaje (në shqip dhe në anglisht) në lidhje me secilën disiplinë.

Për çdo pyetje tjetër apo paqartësi, studentët mund t'u drejtohen përgjegjësve të njësive përkatëse, punonjësve të zyrave të informacionit dhe sekretarive të departamenteve.

PËRMBLEDHJE E RVB TË KATËR FAKULTETEVE

FAKULTETI I EKONOMISË

Konstatime, problematika dhe rekomandime:

Bazuar në vlerësimin e brendshëm, Fakulteti i Ekonomisë ka përmirësuar ndjeshëm cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Megjithatë, për të forcuar më tej këtë progres, rekomandohet:

- Zhvillimi i vazhdueshëm i programeve të studimit në përputhje me zhvillimet ekonomike dhe teknologjike.
- Rritja e angazhimit të fakultetit në projekte ndërkombëtare për shkëmbim akademik dhe kërkimor.

- Thellimi i bashkëpunimit me sektorin privat dhe institucionet publike për të krijuar mundësi më të mira punësimi për studentët.
- Zhvillimi i metodave inovative të mësimdhënies dhe aplikimi i teknologjisë në procesin akademik.
- Nxitja e pjesëmarrjes së studentëve në kërkime dhe projekte praktike për të forcuar përgatitjen e tyre profesionale.

Përmes këtyre masave, Fakulteti i Ekonomisë synon të forcojë pozicionin e tij akademik dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të arsimit të lartë dhe të ekonomisë rajonale.

Bazuar në analizën e raportit të pyetësorit të studentëve, evidentohen disa problematika kryesore që kërkojnë vëmendje për përmirësim. Këto problematika përfaqësojnë aspekte ku perceptimi i studentëve është më i ulët dhe ku ata kanë identifikuar sfida specifike në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe mbështetjes akademike dhe rekomandon:

Një nga sfidat kryesore është pjesëmarrja e ulët e studentëve në plotësimin e pyetësorit, gjë që mund të ndikojë në saktësinë dhe përfaqësimin e përgjithshëm të vlerësimeve. Kjo tregon për një mungesë të ndërgjegjësimit apo motivimit të studentëve për të shfrytëzuar këtë mundësi për të dhënë mendimin e tyre mbi përvojën mësimore.

Raporti tregon se studentët kanë shprehur shqetësime në lidhje me mungesën ose pamjaftueshmërinë e literaturës së rekomanduar dhe të mjeteve teknologjike që përdoren në mësimdhënie. Ky problem përbën një pengesë në mbështetjen akademike që ofrohet, duke ndikuar negativisht në përgatitjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në procesin mësimor.

Një pjesë e konsiderueshme e studentëve kanë vlerësuar negativisht efektivitetin e metodave të mësimdhënies të aplikuara nga disa pedagogë. Kjo përfshin mungesën e përfshirjes aktive të studentëve gjatë orëve të mësimi, gjë që ndikon në angazhimin dhe motivimin e tyre për të marrë pjesë aktive në procesin mësimor.

Studentët kanë përmendur që atmosfera e krijuar nga disa pedagogë në auditor nuk është gjithmonë mbështetëse dhe motivuese. Ka raste për sjellje që nuk i përmbahen standardeve të sjelljes profesionale, çka ndikon në gjendjen emocionale të studentëve dhe në dëshirën e tyre për të bashkëpunuar gjatë orëve të mësimi.

Disa pedagogë janë vlerësuar si të papërgatitur profesionalisht ose kanë vështirësi në menaxhimin efektiv të kohës gjatë orës së mësimi, çka ndikon në cilësinë e mësimdhënies dhe në arritjen e objektivave të kursit. Kjo problematikë vë në pah nevojën për përgatitje më të mirë të pedagogëve për të menaxhuar kohën në mënyrë që të përmbushen të gjitha temat e planifikuara në mënyrë të plotë.

Studentët kanë raportuar sfida në përfshirjen në praktika profesionale të strukturuar dhe me mbështetje të mjaftueshme. Praktika profesionale është e rëndësishme për të siguruar që studentët të përfitojnë nga përvoja praktike dhe të përgatiten për tregun e punës, por mungesa e koordinimit, mbikëqyrjes, dhe mbështetjes së mjaftueshme gjatë praktikës e redukton efektivitetin e saj dhe ndikon në zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve.

Studentët kanë raportuar që interneti në mjediset e universitetit është shpesh i ngadalshëm, me ndërprerje të shpeshta ose i pamjaftueshëm për nevojat e tyre. Kjo mungesë e aksesit në një lidhje interneti të qëndrueshme dhe të shpejtë ndikon negativisht në cilësinë e studimeve dhe zvogëlon mundësinë e përvetësimit të informacionit në kohë reale.

Studentët janë përballur me mungesa të pajisjeve teknologjike moderne, si kompjuterët, projektorët dhe tabelat interaktive në auditore. Pajisjet ekzistuese janë shpesh të vjetruara ose

jo funksionale, gjë që kufizon mundësinë e shfrytëzimit të teknologjisë gjatë mësimin. Kjo mungesë e infrastrukturës teknologjike pengon pedagogët dhe studentët të përdorin metodat e reja të mësimdhënies që përfshijnë mjete digjitale dhe mundëson përfshirjen e tyre në përmbajtjen mësimore.

Një tjetër problematikë e identifikuar është qëndrimi dhe disponibiliteti i stafit ndihmës akademik, i cili nga studentët është perceptuar si jo mjaftueshëm mbështetës. Ky perceptim mund të ndikojë në cilësinë e shërbimeve mbështetëse të ofruara, duke kufizuar përkrahjen që studentët kanë në trajtimin e çështjeve administrative dhe akademike.

Këto problematika kërkojnë masa specifike për të përmirësuar përvojën mësimore të studentëve dhe për të përmbushur pritshmëritë e tyre ndaj institucionit dhe stafit akademik.

ANALIZA SWOT

Pikat e forta

1. Rritja e përpjekjeve të stafit për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.
2. Realizimi i studimit të tregut me qëllim: (i) hapjen e programeve të reja (ii) rivlerësimin e kurrikulave (iii) riorganizimin e programeve egzistuese të studimit (iv) testimin e ecurisë të programeve të studimit (v) gjykimin e nevojave të maturantëve.
3. Realizimi me sukses i procesit të vetëvlerësimit të disa programeve. Përdorimi i përvojës të fituar si nxitje në drejtim të rritjes të cilësisë edhe në programet e tjera të ofruara.
4. Përdorimi me efektivitet i metodave inovative të mësimdhënies. Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies ka qënë interaktiv dhe ka stimuluar eksplorimin e dijes, nëpërmjet diskutimit, aplikimit dhe veprimit duke u përdorur *metodat praktike* dhe ato *eksploruese*.
5. Angazhimi maksimal i stafit dhe studentëve në procesin e vetë-vlerësimit të disa programeve të studimit.
6. Konsolidimi i programeve të studimit që ofrohen nga tre departamentet e fakultetit.

Pika të dobta

1. Mos plotësim i kuotave të miratuara.
2. Cilësi e pamjaftueshme e prurjeve të reja
3. Pjesëmarrje e ulët në projekte, pavarësisht disa sinjaleve inkurajuese.
4. Angazhim i ulët i stafit dhe studentëve në veprimtaritë kërkimore-shkencore
5. Përvetësim në nivel mesatar i dijeve teorike të studentëve.
6. Mungesa e një gjuhe të përbashkët në komunikimin e fakultetit me bizneset, sidomos në sektorin turistik.
7. Konfuzion në gjetjen e rrugëve të duhura lidhur me praktikën e studentëve.

c. Mundësitë

- Eksperienca dhe kualifikimet e stafit akademik rrit mundësinë për të aplikuar dhe bërë pjesë e projekteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare prej të cilave mund të përfitojnë direkt dhe/ose indirekt studentët.
- Shanse për rritjen e bashkëpunimit të Fakultetit me biznesin rajonal.
- Kthimi i fakultetit në një qendër trajnimit me njohuri ekonomike në rajonin juglindor të vendit.
- Pozita e favorshme gjeografike e rajonit për tërheqjen e studentëve edhe nga vendet kufitare për programe të ndryshme studimi.
- Mundësi punësimi si rezultat i rritjes të kërkesës të tregut për profesionin e ekonomistit.

d. Pengesat

- Hapje të programeve të reja në njësitë e tjera kryesore të Universitetit
- Hapja e programeve të reja në Universitetet e tjera
- Faktorët demografikë të cilët projektojnë në të ardhmen një vijim të rënies së numrit të nxënësve të regjistruar në arsimin parauniversitar.
- Vështirësi në rekrutimin e një stafi të kualifikuar
- Vendimmarrje e centralizuar

FAKULTETI I BUJQËSISË

Konstatime, problematika dhe rekomandime:

1. Përmirësimi i programeve të studimit, forcimi i kërkimit shkencor, modernizimi i mësimdhënies dhe zgjerimi i ndërkombëtarizimit janë hapa thelbësorë për të rritur cilësinë dhe ndikimin e Fakultetit të Bujqësisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Përmes këtyre veprimeve, fakulteti do të mund të ofrojë një arsim më të mirë, të përgatisë specialistë të aftë për tregun e punës dhe të rrisë kontributin e tij në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit në fushën e bujqësisë.
2. Sektori për Këshillimin e Karrierës, Vlerësimin Institucional dhe Alumni, UNIKO, duhet të përdorë të dhëna konkrete mbi kërkesën për specialistë në sektorin bujqësor dhe të sqarohen nevojat e identifikuar nga sektori publik dhe privat, duke përfshirë marrëveshjet e bashkëpunimit.
3. Konstatohet se programet e studimit që ofron FB-is janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UNIKO 2022-2027 dhe kërkesat e tregut të punës për specialistë të aftë në këtë fushë. Duhet që të kenë një përfshirje aktive duke e konsideruar si një proces të vazhdueshëm dhe dinamik në studimin e tregut të punës dhe bashkëpunimi me institucionet rajonale që kanë lidhje të drejtpërdrejta me punësimin.
4. Çdo vit akademik NJSBC bën vlerësimin e veprimtarisë akademike me anë të pyetsoreve. Këtë vit është vënë re një numër i ulët i plotësimit të këtyre pyetsoreve nga ana e studentëve të Fakultetit të Bujqësisë.
5. Për të përmirësuar programet e studimit në Fakultetin e Bujqësisë dhe për t'u siguruar që ato mbeten të përditësuara dhe të përputhshme me kërkesat e tregut të punës, mund të rekomandohet një vlerësim periodik i programeve dhe i kurrikulave për t'u siguruar që ato të pasqyrojnë zhvillimet më të fundit në industrinë bujqësore dhe teknologjitë emergjente.

Ky vlerësim mund të përfshijë gjithashtu përfshirjen e ekspertëve nga sektori privat dhe publik për të kontribuar në hartimin e kurrikulave dhe për të ofruar informacion mbi nevojat specifike të punësimit. Kjo do të ndihmojë në sigurimin që programet të mbeten të kërkuara nga punëdhënësit dhe të mundësojnë zhvillimin e aftësive që janë të nevojshme në tregun e punës.

6. Një tjetër rekomandim është rritja e mundësive për praktikë profesionale dhe internshipe në kompani dhe institucione bujqësore, për të garantuar që studentët të zhvillojnë aftësi praktike dhe të krijojnë lidhje profesionale që mund të rrisin mundësitë e tyre për punësim. Shtimi i moduleve që fokusohen në zhvillimin e aftësive të menaxhimit të projekteve dhe komunikimit do të ndihmojë studentët të zhvillojnë shprehje të nevojshme për udhëheqjen dhe menaxhimin në sektorin bujqësor dhe më gjerë. Po ashtu, mund të rekomandohet që programet të ofrojnë mundësi fleksibël për studentët, duke i mundësuar atyre të zgjedhin lëndë elektive që përputhen me interesat dhe qëllimet e karrierës së tyre.
7. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është përfshirja e ish-studentëve në procesin e vlerësimit të programeve, pasi ata mund të ofrojnë një perspektivë të vlefshme mbi përgatitjen që kanë marrë dhe kërkesat aktuale të tregut të punës. Rritja e mundësive për studentët për të përfituar nga projekte ndërkombëtare dhe mundësitë për të ndjekur kurse që lidhen me praktikën më të mira globale në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural mund të ndihmojë në përgatitjen e tyre për tregun global të punës. Për më tepër, përfshirja e temave që lidhen me teknologjitë e reja dhe zhvillimin e qëndrueshëm është gjithashtu e rëndësishme, duke pasur parasysh kërkesat për një zhvillim të gjelbër dhe të qëndrueshëm në industrinë bujqësore. Këto rekomandime mund të ndihmojnë në përmirësimin e programeve të studimit, duke siguruar që ato ofrojnë një arsim të cilësisë së lartë dhe përgatitjen e duhur për studentët për të integruar në mënyrë të suksesshme në tregun e punës.
8. Në Fakultetin e Bujqësisë vëmë re një përpjekje serioze për të ngritur një sistem të përzgjedhjes së personelit akademik bazuar mbi kriteret transparente dhe të meritokracisë. Rëndësi e veçantë i kushtohet edhe vlerësimit të performancës së personelit akademik, si në aspektin e mësimdhënies, ashtu edhe sa i përket veprimtarisë kërkimore shkencore dhe kualifikimit të mëtijshëm. Këta elementë janë pjesë e kontratës së pedagogut.
9. GVB vlerëson se shërbimi i kujdesit ndaj studentit shtrihet nga momenti i regjistrimit të studentit e deri në diplomimin e tij. Krahës këshillimit që ofrohet nga personeli akademik përmes këshillimit akademik, studenti në FB mund t'i drejtohet edhe Qendrës së Karrierës dhe Alumni, për të marrë informacion dhe këshillim akademik për procesin mësimor dhe aktivitetet studentore brenda e jashtë FB-is/UNIKO-së. Vëmendje e veçantë i kushtohet mendimit dhe kërkesave të studentëve ekselentë, me të cilët janë zhvilluar vazhdimisht fokus grupe për të marrë informacion në lidhje me aspektet që kanë nevojë të përmirësohen.
10. Përmirësimi i situatës së paraqitur mund të bëhet përmes disa hapave. Së pari, është e nevojshme rritja e fondit të bibliotekës, duke përfshirë më shumë libra dhe revista, veçanërisht në gjuhë të huaja dhe në fushat kryesore të studimeve si agro-shkenca dhe bujqësia. Po ashtu, mund të zhvillohet një sistem më efikas për huazimin dhe kthimin e materialeve bibliotekare, duke përdorur teknologjinë për menaxhimin më të mirë të fondeve. Për sa i përket literaturës digjitale, duhet të rritet aksesueshmëria e studentëve

dhe pedagogëve në platforma si ProQuest, dhe gjithashtu të sigurohet që të gjithë të kenë mundësinë ta shfrytëzojnë atë gjatë gjithë vitit akademik.

11. Në lidhje me laboratorët, një përmirësim i pajisjeve dhe shtimi i teknologjive të reja mund të ndihmojë në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve, duke ofruar mundësi për kërkime më të avancuara. Gjithashtu, mundësitë për praktikë profesionale dhe internship duhet të rriten, duke ofruar mundësi për studentët që të kalojnë praktika në kompani të bujqësisë dhe agrobiznesit, për të përfituar nga përvoja praktike dhe për të krijuar lidhje me industrinë.
12. Përmirësimi i shërbimeve administrative është gjithashtu i nevojshëm. Duke përdorur më shumë teknologji dhe modernizuar proceset e regjistrimit dhe menaxhimit të materialeve bibliotekare, mund të bëhen më efikasë dhe më të shpejta. Po ashtu, trajnimet e vazhdueshme për stafin administrativ në përdorimin e sistemeve elektronike dhe përmirësimi i arkivave do të ndihmonin për një funksionim më të mirë të institucioneve.
13. Në fund, një hap i rëndësishëm është përmirësimi i infrastrukturës së mësimdhënies, duke shtuar ambiente dhe pajisje didaktike moderne, të tilla si projektorë dhe pajisje teknologjike, që do të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përgatitjen praktike të studentëve. Ky përmirësim i infrastrukturës dhe mundësive të studimit do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi më të zhvilluar dhe më të përshtatshëm për studentët dhe stafin akademik.

Standardi	Konkluzione	Rekomandime
Programet e Studimit (I.1, II.1, II.2, II.4)	Programet janë në përputhje me misionin dhe qëllimet, duke ruajtur vlerat kombëtare dhe kulturore.	Përmirësimi i vlerësimit të programeve me metodologji më të avancuara për monitorimin dhe përmirësimin e tyre.
Personeli Akademik dhe Administrativ (III.1-III.4)	Procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit janë transparente dhe ndjekin standardet ligjore.	Angazhimi në trajnime të vazhdueshme për personelin për të rritur kualifikimin dhe nivelin profesional.
Përkujdesja për Studentët (IV.1-IV.4)	Politikat për mirëpritjen e studentëve dhe informimin për mundësitë e punësimit janë të pranishme.	Zhvillimi i një platforme online për mundësitë e punësimit dhe praktikave.
Infrastruktura dhe Pajisjet (V.1, V.2)	Biblioteka dhe laboratorët janë të disponueshme për studentët për mësim dhe formim praktik.	Investim në modernizimin e laboratorëve dhe infrastrukturës për praktikat profesionale.

Bashkëpunimi (VII.1, VII.2)	Bashkëpunimi mes personelit dhe institucioneve të jashtme është i frytshëm dhe mbështet zhvillimin akademik.	Rritja e mundësive për bashkëpunim ndërkombëtar për të rritur cilësinë e arsimit dhe shkëmbimin e përvojave.
Sigurimi i Cilësisë (VIII.1)	Institucioni garanton cilësinë e programeve të studimit.	Implementimi i instrumenteve të matjes për monitorimin e cilësisë dhe përmirësimin e ecurisë së programeve të studimit.

ANALIZA SWOT

Faktorët	Pikat e Forta (Strengths)	Pikat e Dobëta (Weaknesses)	Mundësitë (Opportunities)	Kërcënimet (Threats)
Programet e Studimit	- Në përputhje me misionin dhe vlerat kombëtare. - Programet janë të detajuara dhe të informuara. - Fokus në nevojat e tregut të punës.	- Mund të ketë mungesë inovacioni dhe diversiteti në disa fusha studimi. - Nevoja për përmirësime në metodologjinë e vlerësimit të programeve.	- Mundësia për të implementuar programe të reja që përputhen me kërkesat ndërkombëtare. - Përmirësimi i vlerësimit të programeve përmes metodave të avancuara.	- Ndryshimet në kërkesat e tregut të punës mund të kërkojnë adaptim të shpejtë. - Konkurenca nga institucione të tjera arsimore.
Personeli	- Procedura e rekrutimit është transparente. - Përdorimi i një baze të dhënash për menaxhimin e personelit. - Kualifikimi i vazhdueshëm i personelit është i mbështetur.	- Mund të ketë mungesë trajnimesh të avancuara për personelin në disa fusha. - Kërkohej angazhim më i madh në trajnime për personelin administrativ.	- Mundësia për të zhvilluar mundësi trajnimi dhe kurse për personelin për t'i mbajtur ata në nivele të larta të kualifikimit. - Angazhimi në programe ndërkombëtare të trajnimit.	- Mungesa e fondeve mund të ndikojë në përpjekjet për kualifikim të vazhdueshëm. - Mund të ketë mungesë stafesh me kualifikime të nevojshme.

Përkujdesja për Studentët	- Politika e mirëpritjes së studentëve është e qartë. - Informimi për mundësitë e punësimit është i disponueshëm. - Personeli angazhohet për mbështetje studentore.	- Mund të ketë mangësi në mbështetje për studentët në kërkimin e mundësive të punësimit. - Statistikat për studentët mund të mos jenë të përditësuara.	- Mundësia për të zhvilluar më shumë mundësi për punësim dhe praktika profesionale për studentët. - Platforma online për mundësitë e punësimit.	- Konkurenca nga institucionet e tjera arsimore që ofrojnë mundësi më të mira për studentët. - Ndryshimet në kërkesat e tregut të punës.
Infrastruktura dhe Pajisjet	- Biblioteka dhe laboratorët janë të disponueshëm dhe të përshtatshëm. - Infrastruktura e nevojshme për mësimin praktik është në vend.	- Nevoja për investime të mëtejshme për përmirësimin e infrastrukturës, veçanërisht për laboratorët dhe mjediset për praktikë. - Mundësi për modernizim të pajisjeve.	- Mundësia për të investuar në teknologji të avancuara për mjediset mësimore dhe laboratorët. - Pjesëmarrja në projekte për modernizimin e infrastrukturës.	- Kufizime financiare që mund të ndikojnë në investime të nevojshme në infrastrukturë. - Rritja e kërkesës për teknologji më të avancuara.
Bashkëpunimi	- Bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare dhe aktorë të biznesit është i frytshëm. - Marrëdhëniet me personelit janë të forta dhe produktive.	- Bashkëpunimi mund të jetë më i thelluar dhe i larmishëm në disa fusha. - Niveli i bashkëpunimit me biznesin mund të përmirësohet.	- Mundësia për të zgjeruar rrjetet e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe me institucione të tjera arsimore dhe biznesin. - Mundësi për projekte të reja bashkëpunimi.	- Ndikimi i krizave ndërkombëtare mund të pengojë mundësitë për bashkëpunim. - Konkurenca nga institucione të tjera me mundësi më të mira bashkëpunimi.

Konstatime, problematika dhe rekomandime:

1. Për sigurimin e cilësisë në FEF, tregohet kujdes i veçantë. Ai, ashtu si në gjithë strukturat e UNIKO-së konsiderohet përparësi për secilin punonjës, ndiqet me kujdes nga strukturat drejtuese dhe monitorohet në mënyrë permanente nga NJSBC. Përvoja e derisotme dëshmon për nevojën e një kontrolli të tillë, për domosdoshmërinë e një njësie të posaçme monitorimi, që orienton institucionin drejt plotësimit të standardeve të cilësisë dhe shërben si forcë shtytëse për një performancë në rritje në nivel institucioni dhe për çdo individ.
2. Feedback –u i marrë nga kontakti me ish-studentët e tij, Alumni, të cilët janë mësues në shërbim dhe zhvillojnë pranë Qendrës së Formimit të Vazhduar trajnime të përvitshme në sesione të ndryshme gjatë vitit në kuadër të zhvillimit profesional, sipas akteve ligjore në fuqi, janë një element i rëndësishëm që mbahet parasysh lidhur me cilësinë e programeve që ofron fakulteti.
3. GVB vëren se FEF ka krijuar lidhje të qëndrueshme me një mjaft institucione të administratës publike që janë palë interesi për programet që ofron për të lehtësuar procesin e praktikave profesionale të studentëve, si edhe punësimin e ardhshëm të tyre. Kë këtë kuadër, UNIKO zhvillon çdo vit edhe Panairin e Punës, pjesë e të cilit është dhe FEF, për të lehtësuar kontaktin e studentëve me kompani nga më të rëndësishmet në Shqipëri, me synim punësimin e mundshëm të studentëve në to. Edhe periudha kohore e zhvillimit të Panairit të Punës, përkon pikërisht me fundin e vitit akademik për të krijuar sa më shumë mundësi për studentët në prag diplomimi.

Rekomandime të nxjera nga departamentet

- Të vazhdohet mbështetja për projektet kërkimore dhe aktivitete shkencore ndërkombëtare.
- Të intensifikohet bashkëpunimi me institucione të tjera akademike për shkëmbim eksperiencash dhe njohurish.
- Të inkurajohet më shumë angazhimi i stafit akademik në programe doktorature dhe formime të tjera profesionale.
- Të krijohet një platformë për lidhjen e studentëve dhe pedagogëve me mundësi mobiliteti dhe projekte ndërkombëtare për të rritur angazhimin e tyre në kërkime shkencore.
- Të zhvillohet një strategji e qartë për partneritetet me institucione të tjera akademike dhe të sektorit privat për të forcuar bashkëpunimin në projekte kërkimore me buxhete të kufizuara.
- Të angazhohen më shumë mësime ndërkombëtare në aktivitete ndërkombëtare të botimeve shkencore për të përmirësuar vizibilitetin e kërkimit shkencor dhe të përfshihen në revista me faktor impakti të lartë.
- Të rritet përfshirja e studentëve në projekte kërkimore.
- Të sigurohet lidhja mes kërkimeve dhe praktikës në arsim.
- Të zhvillohen projekte të reja ndërkombëtare dhe të sigurohen më shumë burime financiare drejt kërkimit dhe mësimeve.

ANALIZA SWOT

FEF ka një vizion dhe mision të qartë dhe të mirëpërcaktuar, duke treguar drejtimin e qartë të institucionit.

Ai mbështetet nga ekspertiza e një stafi të kualifikuar. Programet janë ndërtuar duke marrë mbështetje dhe ekspertizë nga përvoja më e mirë vendase dhe e huaj, dhe duke siguruar një perspektivë bashkëkohore.

Personeli akademik me tituj dhe përvojë domethënëse është pikë mbështetjeje e fortë, duke siguruar cilësi në mësimdhënie dhe hartime programesh në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Pikat e forta:

- Staf akademik i kualifikuar;
- Arritje të kënaqshme në fushën e kërkimit shkencor (konferenca, botime);
- Numri i kënaqshëm i mobiliteteve për shkëmbim dhe transferim përvojë;
- Organizimi i aktiviteteve shkencore, kulturore, letrare dhe sportive;
- Mjedise dhe infrastrukturë bashkëkohore, që krijon mundësitë për zhvillimin cilësor të punës mësimore;
- Rishikim i vazhduar i kurrikulave dhe syllabuseve në përputhje me standardet bashkëkohore të mësimdhënies;
- Integrimi i kërkimit shkencor me procesin e mësimdhënies;
- Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor;
- Organizim efektiv i praktikave profesionale

Pikat e dobëta

- Forcimi i lidhjeve më të gjera me institucione të tjera kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare;
- Rënie të numrit të të regjistruarve, për arsye të mesatares të vendosur nga MASR dhe ndryshimeve demografike të rajoni e me gjerë;
- Gjetja e mekanizmave më të përshtatshëm/ frytdhënës për promovimin e programeve tona të studimit;
- Vjetërsia e kompjuterave të stafit akademik dhe mungesa e wireless-it;
- Mungesa e bibliotekës digjitale;
- Pasurimi i fondit ekzistues të bibliotekës së FEF me vepra që u vijnë në ndihmë studentëve në procesin mësimor;
- Mungesa e një mjedisi të përshtatshëm sportiv për lëndë kurrikulare dhe aktivitete jashtë kurrikulare.

Sigurimi i cilësisë në programet e studimit

Për të arritur objektivat e caktuara të sigurisë së cilësisë në programet e studimit dhe për të avancuar procesin e ndërkombëtarizimit të institucioneve akademike, janë realizuar një sërë

aktivitetesh që lidhen ngushtë me përmirësimin e cilësisë dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Aktivitetet e realizuara kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në përmbushjen e këtyre objektivave dhe janë të matshme në mënyra të ndryshme.

Sigurimi i cilësisë në programet e studimit është arritur përmes monitorimit të vazhdueshëm të ofertës akademike, mbështetjes për zhvillimin e programeve të reja dhe monitorimit vjetor të programeve ekzistuese. Ky proces është gjithashtu i lidhur ngushtë me përmirësimin e lidhjes mësues-nxënës dhe analizën e procesit didaktik. Kjo ka për qëllim të identifikojë fushat që kërkojnë përmirësime dhe të ofrojë mundësi për zhvillim të mëtejshëm në mënyrë që cilësia të mbetet e lartë dhe e përshtatshme me kërkesat e tregut.

Në kuadër të **ndërkombëtarizimit**, disa aktivitete të matshme janë realizuar për të arritur synimet e caktuara. Rritja e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete dhe institucione kërkimore jashtë Shqipërisë ka sjellë mundësi të reja për zhvillim shkencor dhe edukativ. Aplikimi dhe fitimi i projekteve kërkimore ndërkombëtare është një tjetër arritje e rëndësishme, e cila ka forcuar pozitën e institucionit në arenën ndërkombëtare.

Përveç kësaj, ka pasur një angazhim të theksuar për **mobilitetin ndërkombëtar**, duke përfshirë pjesëmarrjen e stafit akademik, administrativ dhe studentëve në programet e mobilitetit ndërkombëtar. Kjo ka kontribuar në zhvillimin e shkathtësive të stafit dhe studentëve, si dhe ka ofruar mundësi për ndërlidhje më të forta me universitete të tjera europiane.

Një nga arritjet më të rëndësishme ka qenë hapja e programeve të përbashkëta me universitete europiane, ku janë ngritur grupe ndërfakultetore për aplikimin në projekte të rëndësishme si Erasmus+ KA2 (për ngritjen e kapaciteteve), përmendim rastin e bashkëpunimit me Netherlands Business Academy: Kulturë, trashëgimi kulturore dhe qytetërim europian . Këto projekte, të fokusuara në fushat si kultura, trashëgimia kulturore, menaxhimi në turizëm dhe lidhshipin, kanë hapur mundësi të reja për zhvillim akademik dhe profesional. Gjithashtu, ngritja e grupeve të punës dhe aplikimi për doktoratura të përbashkëta me universitete të njohura të Europës, si Universiteti i Sofjes dhe Universiteti i Timoshuarës ku u ngritën grupet e punës dhe u aplikua për një doktoraturë të përbashkët me Universitetin e Timoshuarës në “Studime Gjuhësore dhe Etnokulturore”, ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin e bashkëpunimeve akademike ndërkombëtare dhe ka rritur mundësitë për shkëmbim dhe kërkime shkencore në nivele të larta.

Këto aktivitete kanë kontribuar jo vetëm në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, por edhe në forcimin e lidhjeve ndërkombëtare dhe ngritjen e nivelit të kërkimit dhe arsimit.

Sigurimi i cilësisë në departmentet e fakultetit

Në përputhje me Nenin 32, pika 1, të Ligjit Nr. 80/2015, dt. 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë,” departamentet në FEF realizojnë një analizë vjetore për të vlerësuar ecurinë e procesit mësimor dhe kërkimor gjatë çdo viti akademik duke përpiluar një raport që ka për qëllim të identifikojë drejtimet kryesore të veprimtarisë akademike, përfshirë qëndrueshmërinë e programeve ekzistuese, risitë dhe përmirësimet në kushtet e mësimdhënies dhe mësimnxënies, përshtatjen e rregulloreve të programeve me kërkesat e tregut të punës në

rajon, ngarkesën mësimore dhe burimet e literaturës. Po ashtu, ai fokusohet në rolin e studentëve si aktorë të rëndësishëm të këtyre proceseve dhe në zhvillimin e aktiviteteve kërkimore dhe shkencore nga stafi akademik i departamentit.

Analiza e sigurimit të cilësisë ka për qëllim jo vetëm të evidentojë arritjet e deritanishme në këto fusha, por edhe të përshkruajë zhvillimin e departamenteve në përmbushjen e Standardeve të Sigurimit të Cilësisë për programet e studimit që ofrojnë. Ajo reflekton edhe mbi rekomandimet e ekspertëve për transformimin e UNIKO, duke shërbyer si një raport vetëvlerësimi që identifikon masat për përmirësimet e nevojshme. Për vitin akademik 2023-2024, raporti përqendrohet në pasqyrimin e situatës aktuale të secilit departament. Ai synon që gjetjet të shërbejnë si bazë për hartimin e planeve konkrete për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore të vitit akademik 2024-2025.

FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE

Konstatime, problematika dhe rekomandime:

Rekomandimet u mbështetën tek plani strategjik afatgjatë i institucionit dhe tek objektivat dhe qëllimet e njësisë bazë dhe të njësisë kryesore. Mbështetur tek rekomandimet dhe problematikat e përfshira në raportin e analizës vjetore të vitit të kaluar, në këtë raport është përfshirë edhe informacioni përkatës mbi strategjitë e ndërmarra për realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit, si dhe masat e nevojshme për eliminimin e disa prej pikave të dobëta të brendshme potenciale.

Në raportin që u mbajt gjatë analizës vjetore 2023-2024 u shprehën qartë qëllimet dhe objektivat e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore.

Përdorimi i internetit në funksion të mësimit është një aspekt që ka nevojë për përmirësime të mëtejshme, sidomos për të adresuar mendimet e studentëve që kanë përvoja negative. Kjo nënkupton nevojën për investime në infrastrukturën teknologjike, trajnime për pedagogët për përdorimin e mjeteve digjitale dhe rishikim të politikave të përdorimit të internetit për të maksimizuar përfitimet e tij në procesin mësimor.

Efektiviteti i metodave të mësimdhënies, përdorimi i mjeteve mësimore dhe lidhja teori-praktikë kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme. Përpjekjet për të adresuar këto fusha do të ndihmonin në rritjen e cilësisë së përgjithshme të mësimdhënies dhe përvojës studentore.

Përsa i përket literaturës të dhënat tregojnë se përmbajtja mësimore është vlerësuar pozitivisht nga shumica e studentëve, por ka vend ku përmirësimet mund të sjellin përfitime

edhe më të mëdha, si ofrimi i më shumë literaturës shtesë dhe përmirësimi i komunikimit në auditor. Këto ndërhyrje do të ndihmonin në rritjen e cilësisë së përgjithshme të mësimdhënies.

Fakulteti ka në përbërjen e vet disa departamente, të cilët në specifikën e vet kanë një lidhje koherente dhe logjike të lidhur ngushtë me zhvillimin e praktikës mësimore, sepse edhe diplomimi i studentëve sipas programeve të studimit bëhet në lidhje me ato profesione me të cilat zhvillimi i praktikës mësimore është vendimtar, siç janë profesioni i infermierit të përgjithshëm ose profesioni i mësimdhënësit.

ANALIZA SWOT

Sigurimi i cilësisë në programet e studimit

- monitorimi i ofertës
- mbështetje për programet e reja
- monitorimi vjetor
- lidhja mësues-nxënës
- analiza e procesit didaktik (përmirësime)

Sigurimi i cilësisë në departament

- analiza vjetore e departamentit dhe rishikimi i procesit
- analiza e procesit të sigurimit të cilësisë
- fusha që kanë nevojë për përmirësim (për secilën fushë të shtohet problematika, rekomandimi, nëse është problematikë e vazhdueshme, nëse është zgjidhur ose përmirësuar)

Sektori i Kurrikulës dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Evis Kapurani

